

Java I TEMA: HYRJE NË KONTABILITET

Kontabiliteti gjen përdorim të gjerë në jetën e përditshme nga shumica e njerëzve dhe individëve. Imagjinojmë vetëm psh mjetet e kufizuara (paratë e pamjaftueshme) që janë në dispozicion të një familje për të financuar shpenzimet dhe kostot e tjera të jetesës, pastaj mjetet në dispozicion të një studenti i cili duhet të financoj shpenzimet e shkollimit, udhëtimit, ushqimit etj. Kjo është një arsye se përse secili prej nesh duhet që kohë pas kohe të bëjë disa llogaritje duke mbajtur disa shënime për mjetet në dispozicion dhe shpenzimet që është duke bërë.

Shembull:

Sara është një studente e cila për secilin muaj ka në dispozicion 150 €, për shpenzimet e studimeve të saj. Asaj do të duhet të bëjë një llogaritje të thjeshtë për të pasur një situatë të kurtër për gjendjen e saj financiare dhe në rast nevojë dhe për të raportuar te personat që e financojnë atë, nëse janë duke i mjaftuar apo jo këto para për mbulimin e shpenzimeve mujore të studimeve.

Pra siç thamë shuma e parave të gatshme në dispozicion të Sarës është 150 €, kurse ajo gjatë muajit ka bërë këto shpenzime:

- Kësti mujor i paguar ndaj fakultetit	65.00 €
- Shpenzimet e udhëtimit	25.00 €
- Shpenzimet e ushqimit	30.00 €
- Shpenzime për material shkollor	20.00 €
- <u>Shpenzime tjera</u>	<u>10.00 €</u>
Shpenzime gjithsej	150.00 €

Pra Sara ka bërë një plan të mirë të shpenzimeve të parave të saj falë mbajtjes së një llogarie për shpenzimet e parave në dispozicion. Po çfarë do të mundë t'i ndodhte nëse nuk do të kalkulonte këto shpenzime.

Pra ajo me siguri se tërë shumen mujore të parave në dispozicion do ta shpenzonte para fundit të muajit dhe kështu do të mbeste pa para.

Shtrohet pyetja se çfarë na thotë ky shembull kaq i thjesht?

Pra ky shembull na jep të kuptojmë se kontabiliteti është i pranishëm po thuaj se në çdo aspekt të jetës dhe se secili nga ne në një mënyrë apo tjetër i bëjmë llogaritjet për pasurinë, obligimet, të hyrat, shpenzimet, etj. Po ashtu njëjtë edhe një kryefamiljari do t'i duhet të mbaj shënime dhe bëjë llogaritje për kostot e jetesës për familjen e tij.

Po ashtu edhe një biznes sado i vogël që të jetë, pronari apo menaxheri i tij do të duhet të përdorë kontabilitetin në mënyrë që të jetë në gjendje të dijë se cili do të mundë të jetë rezultati nga afarizmi i tij, dhe po ashtu ky rezultat do të jetë në interes edhe për një numër të palëve të interesuara.

Shembull:

Miri ka marrë vendim për fillimin e një biznesi i cili do të prodhoj një produkt ushqimor të cilin do t'ua ofroj shitoreve qa ata ta shesin nëpër dyqanet e tyre, kurse nga shitja e produktit të tij ai do të mundë të realizoj të hyra prej 5,000 € për çdo muaj.


Zgjidhja:

Miri kalkulon koston e tij mujore:

Kostot e prodhimit	2,600 €
Pagat	800 €
Qiraja	250 €
Shpenzime administrative	150 €
Shpenzime e rrymës	200 €
<hr/>	
Totali	4,000 €

Siç thamë më parë se të hyrat e realizuara janë 5,000 € për çdo muaj, kurse tani është koha që këtyre të hyrave tua zbresim (bashkërendojmë) kostot e bëra për ti realizuar këto 5,000€.

Tani fillojnë llogaritjet për të nxjerrur profitin e Mirit, i cili do të llogaritet në vazhdim:



Pra siç mundë të shihet nga shembulli i paraqitur për aktivitetit biznesor të Mirit, kuptojmë se përdorimi i llogaritjeve ndihmon për të ardhur deri te një informacion kontabël për arsyeshmërinë e marrjes së vendimit për zhvillimin e këtij biznesi.

Organizimet e bizneseve dhe llojet e tyre

Llojet e bizneseve

Çdo organizim në shoqëri i cili qëllim parësor e ka profitin mundë të emërtohet "Biznes". Zakonisht bizneset dallohen për nga mënyra se cila është veprimtaria operuese e tyre, dmth

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java I 09/03/2015

prej cilës veprimtari rrjedhin të hyrat e tyre. Në praktikë ekzistojnë tri forma kryesore të veprimtarisë së biznesit:

- Biznese prodhuese
- Biznese tregtare
- Bizneset shërbyese.

Bizneset prodhuese duke prodhuar produktet dhe më pas përmes plasimit të tyre në treg i gjenerojnë të hyrat nga shitja e produkteve të prodhuara.

Shembull:

Kompania "X" merret me prodhimin e lëngjeve (pijeve) nga frutat, kurse për të realizuar produktin para se të dal në treg, kjo kompani ka edhe kosto dhe shpenzime të tjera. Për të ilustruar më mirë si funksionon një biznes nga veprimtaria prodhuese, do të shpjegohet në këtë mënyre:

Të hyrat nga shitja e prodhimeve	12,000 €
{	Materiali direkt - frutat ne stoqe dhe te blera nga pemëtarët dhe fermerët (6,000 €)
	Puna direkte – fuqia punëtore, (4,000 €)
	Shpenzimet tjera(500 €)

Pra, kjo është një përshkrim i thjeshtë se si funksionon një biznes prodhues ku nga materiali direkt apo lënda e parë që në këtë rast janë frutat e freskëta me të cilat furnizohet nga fermerët individual, duke i shtuar edhe punën direkte, si dhe shpenzime të tjera direkte, kompania "X" arrin të prodhoj një produkt final i dedikuar për treg.

Bizneset tregtare veprimtari kryesore të tyre e kanë blerjen e mallrave të ndryshëm nga bizneset prodhuese dhe të tjera, kurse të njëjtat mallra pastaj e shesin palëve të tjera siç mundë të jenë tregtarët e me pakicë apo blerësit individual për nevoja të konsumit final.

Në mesin e shumë mallrave që biznesi i tregton, mundë të jetë edhe produkti i kompanisë prodhuese "X" që u përmend më parë, nga e cila kompani prodhuese blihet produkti "lëng frutash" për tu shitur më tej.

Bizneset shërbyese aktivitet primar të tyre e kanë ofrimi (shitjen) e shërbimeve klientëve të tyre.

Si shembull të një kompanie shërbyese mundë të merret p.sh Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, kompani kjo e cila veprimtari primare e ka ofrimin e një numri të madh të shërbimeve për klientët, duke ofruar shërbime për kompanitë fluturuese që operojnë në këtë aeroport, aviokomanive që u siguron aterrim dhe shfrytëzimin e pistës së aeroportit, si dhe klientëve individual të cilët përdorin këtë aeroport për udhëtimet e tyre. Pra sikurse dy llojet e veprimtarive që u përmendën më herët, po ashtu edhe veprimtaria shërbyese gjatë zhvillimit të aktivitetit të saj afarist ka kosto të operimit dhe shpenzime të tjera.

Ushtrime (bashkëbisedim)

Mundohuni të identifikoni dhe përmendini së paku pesë biznese nga secila veprimtari (prodhuese, tregtare, dhe shërbyese) në afërsinë e vendit ku jetoni.

Organizimet formale të biznesit

Bazuar në organizimin formal të bizneseve dallohen tri lloje të formës së organizimit të bizneseve:

1. Bizneset inokse (individuale)
2. Bizneset partnere (ortakëritë)
3. Korporatat (shoqëritë aksionare)

1 Bizneset inokose zakonisht njihen me termin si “biznese individuale” apo “persona të vetëpunësuar”, për arsye se zakonisht janë personat (individët) të cilët i themelojnë këto biznese për të punësuar vetën e tyre. Kjo njëkohësisht është edhe mënyra më e lehtë që një individ të marrë vendim për themelimin e një biznesi të tillë. Mirëpo edhe ky lloj i bizneseve mundë të ketë disa persona të punësuar.

Pra pronarët e këtyre bizneseve janë njëkohësisht menaxher dhe pronar duke pasur përgjegjësi të pakufizuara si në udhëheqjen e biznesit ashtu edhe në obligimet ndaj palëve tjera.

Shembuj të organizimit të kësaj forme të biznesit janë nga veprimtaria e zanatit dhe profesione të caktuara e që ndër të tjera mundë të numërohen:

- Mekanikët dhe automekanikët
- Sallonet dhe dyqanet e flokëtarëve, bukurisë
- Fermerët individual

- Dyqanet dhe shitoret e ndryshme me pakicë, etj

Përparësitë e organizimit dhe funksionimit të biznesit individual janë:

- Lehtë për t'u themeluar,
- Kontroll e plotë nga pronari,
- Lehtë për t'u mbyllur aktivitetin etj

Mangësitë apo të metat e kësaj forme të organizimit të biznesit janë

- Vështërsitë e sigurimit të kapitalit,
- Përgjegjësi e pakufizuar,
- E papërshtatshme për më shumë pronarë,
- Biznesi i lidhur vetëm për një pronar, etj.

Po ashtu, duhet përmendur se, me gjithë përgjegjësinë e pakufizuar ajo çfarë është me rëndësi të përmendët është se kontabiliteti i këtyre bizneseve duhet të mbështetet në parimin e entitetit afarist, parim ky i cili nënkupton se kontabiliteti i këtyre bizneseve duhet të jetë i veçuar nga pasuria personale e tij.

Shembull:

Personi "X" një pjesë nga kursimet e tij ka vendosur që ti investoj në themelimin e një biznesi. Ai i investon në biznesin e tij shumën prej 5,000 euro në llogarinë e biznesit. Pasi të ketë filluar aktivitetin e tij ai këto para të investuara do ti llogarisë si kapital i investuar dhe asnjë herë nuk do të shpenzoj më ato para të investuara për nevoja familjare. Është tjetër gjë ajo që e trajton kontabilitetit që bëhet në emër të tërheqjeve të pronarit.

2 Bizneset partnere janë në pronësi të dy a më tepër individëve apo personave fizik, të cilët organizohen për të zhvilluar biznesin me qëllime përfitimi. Organizimi dhe themelimi i partneritetit mundë të bëhet pas një marrëveshje në mes të partnerëve të ardhshëm kurse shumat e deponuara mbahen veç e veç për secilin partner në llogarinë e kapitalit

Shembuj të thjeshtë të partneritetit mundë të jenë si p.sh:

- Zyrat që ofrojnë shërbime profesionale (avokatët, noterët, këshilltarët tatimor),
- Restorantet,
- Ordinancat mjekësore, etj.
- Shembull:

Mundë të supozojmë se Vesa, Rina dhe Agon duan të themelojnë një partneritet me pjesëmarrje të ndryshme të kapitalit. Pas një pune të suksesshme ata kanë arritur një fitim të cilin duhat ta ndajnë në bazë të pjesëmarrjes së kapitalit të deponuar nga secili.

Pra ata do të vendosin të ndajnë shumën prej 1,000 €, me normën 5:3:2

Zgjedhja

Shuma e pjesëve të normës është $5+3+2=10$, Secila pjesë vlenë $1000 \text{ €} \div 10 = 100 \text{ €}$

Vesa: $5 \times 100 \text{ €} = 500 \text{ €}$

Rina $3 \times 100 \text{ €} = 300 \text{ €}$

Agon $2 \times 100 \text{ €} = 200 \text{ €}$

total 1,000 €

3 Korporatat janë entitete të themeluara në mënyrë që aksionarët e tyre të përfitojnë nga përgjegjësia e kufizuar pasi që aksionarët janë përgjegjës vetëm për shumën e paguar si aksione që i kanë në posedim. Pra, pasuria e korporatës është e veçantë nga pasuria e themeluesve dhe e aksionarëve të korporatës.

Përparësitë e organizimit në formë të korporatë janë:

- Se përgjegjësia është e kufizuar, dhe kjo e bën investimin më pak të rrezikshëm në krahasim me investimin nga biznesi individual,
- Është më e thjeshtë të financohet pasi që përgjegjësia është e kufizuar dhe nuk ka kufizimi sa i përket numrit të aksionarëve
- Kompania do të vazhdojë të ekzistojë me gjithë tërheqjen e njërit nga aksionarët,
- Është më e lehtë të transferohen aksionet prej njërit pronar te tjetri në krahasim me bizneset ortakërisë ku në rast se tërhiqet njëri nga ortakët biznesi duhet mbyllur tërësisht, për të filluar me rishtazi me ortakët e ri.

Pengesat apo vështërsitë e organizimit në formë të korporatë janë:

- Raportimi i pasqyrave financiare të korporatave duhet të përgatiten sipas kërkesave ligjore dhe të kontabilitetit, e po ashtu duhet të përgatiten sipas standardeve të kontabilitetit
- Duhet të publikojnë pasqyrat vjetore financiare të tyre,
- Pasqyrat financiare duhet të jenë të audituara nga auditor të certifikuar dhe të pavarur,
- Emetimi i aksioneve rregullohet me ligj.


Entitetet joprofitabile

Entitetet të cilat themelohen me qëllim që të ndihmojnë në plotësimi e nevojave të ndryshme me karakter bamirësie apo humanitare në të mirë të shoqërisë njihen ndryshe si organizmat joqeveritare joprofitabile. Do të thotë se e tërë aktiviteti dhe veprimtaria e tyre janë në shërbim të qytetarëve dhe si rezultat nuk gjenerojnë fitime.

Roli i kontabilitetit për biznesin

Kontabiliteti është procesi i identifikimit, regjistrimit, përmbledhjes dhe raportimit të informacionit ekonomik për marrjen e vendimeve.

Ky definicion për kontabilitetit paraqitet në vazhdim edhe në mënyrë grafike:



Shembulli i definicionit të kontabilitetit është paraqitur në mënyrë grafike ku mund të veçohet dhe analizohet secila fazë e procesit të analizimit të informatave që kontabiliteti i trajton në mënyrë që nga ndërmarrja të dalë një vendim kualitativ dhe i drejtë.

Shembull:

Kompania "X" ka të organizuar departamentin e kontabilitetit në selinë qendrore të sajë. Departamenti i kontabilitetit gjat procedimit të dokumenteve voluminoze do të identifikon, regjistron dhe komunikon informata që janë:

- Relevante, këto informata quhen relevante nëse ndihmon përdoruesit të vlerësojnë ngjarjet e kaluara, të tashme, ose të ardhme. Informacionet relevante përdorën për të parashikuar pozicionin dhe performancën e ardhshme financiare të ndërmarrjes "X"
- Të besueshme pasi që përdoruesit brenda ndërmarrjes do të duhet të marrin vendime vetëm mbi bazën e informacioneve të besueshme, të cilat nuk përmbajnë shtrembërime dhe gabime materiale.
- Pasqyrat financiare do të duhet të jenë të krahasueshme me me njëra tjetrën, p.sh pasqyrat financiare të vitit vijues do të duhet të jenë të krahasueshme me ato të vitit të kaluar, po ashtu edhe pasqyrat financiare të Kompanisë "X" do të duhet të jenë të krahasueshme me ato të kompanive të tjera nga, si brenda vendit ashtu edhe jasht tij.

Dy degët kryesore të kontabilitetit janë:

1. Kontabiliteti financiar
2. Kontabiliteti i menaxhmentit

Kontabiliteti financiar është fushë e kontabilitetit, qëllimi themelor i të cilit është përgaditja e pasqyrave financiare mbi bazën e rregullave të caktuara siç janë: parimet e përgjithshme të pranuar të kontabilitetit

Roli i rëndësishëm i kontabilitetit në vlerësimin e pozitës financiare të ndërmarrjes, pa dyshim operacionalizohet më së miri duke i përdorur analizat e pasqyrave financiare.

Një komplet i pasqyrave financiare dhe i përgatitur në harmoni me SNK përbëhet nga:

- a) Bilanci i gjendjes – është një listë e pasurive në zotërim të biznesit si dhe detyrimeve në një datë të caktuar dhe të cilat shprehen në vlerë monetare
- b) Pasqyra e të ardhurave – është regjistër ku mbahen të hyrat e gjeneruara dhe shpenzimet e bëra për gjenerimin e atyre të hyrave për një periudhë të caktuar
- c) Një pasqyrë e cila prezanton;
 - 1) Tërë ndryshimin e kapitalit të vet
 - 2) Ndryshimin e kapitalit të vet, por jo edhe ndryshimin që është rezultat i transaksioneve kapitale në mes të pronarëve dhe distribuimi ndaj pronarëve.

- d) Pasqyrën e rrjedhjes së keshit e cila pasqyrë raporton për neto rrjedhën e parave të gatshme nga aktivitetet operative, investive dhe financiare, duke përdorur dy metodat siç janë metoda direkte dhe indirekte
- e) Politikën kontabël dhe njoftimet shpesh, ku shpallën informacionet në lidhje me metodat e dhe mënyrat e krijimit të pasqyrave si dhe informacione të tjera.

Përdoruesit e informatave të kontabilitetit financiar

Janë një numër i madh i të interesuarve për informacionet të cilat prezantohen në pasqyrat financiare siç janë:

Përdoruesit kryesor intern janë kryesisht të interesuarit brenda ndërmarrjes përkatësisht menaxhmenti i ndërmarrjes sidomos menaxhmenti financiar është i interesuar për këto informacion pasi që mbi bazën e këtyre informatave ai mundë të përcaktoj:

- Nevojat për mjete financiare dhe për mjete tjera
- Vlerësoj efikasitetin e strukturës së kapitalit
- Të vlerësoj rregullsinë e vendimeve investuese
- Të propozoj korrektura në treguesit e planifikimit
- Të përpunoj dhe realizoj politikën e pagave, dividendës etj.

Përdoruesit nga grupet eksterne apo atyre jashtë ndërmarrjes janë kryesisht nga aksionarët si dhe investitorët potencial të ndryshëm.

Aksionarët ekzistues janë të interesuar për dividendë, prandaj i shfrytëzojnë këto informata për ta kuptuar saktë se si është gjendja e ndërmarrjes, në mënyrë që ata të vendosin nëse do të mbajnë edhe më tutje aksionet apo ti shesin aksionet e tyre. Po ashtu edhe aksionarët potencial të ardhshëm janë të interesuar që të dinë për mundësinë e realizimit të dividendës në kompaninë e caktuar dhe në bazë të rezultateve të prezantuara në pasqyra financiare vendosin nëse do të investojnë në kompani përmes blerjes së aksioneve.

Obligacionmbajtësit, bankat dhe kreditorët janë të interesuar nëse ndërmarrja do të jetë në gjendje të përmbush detyrimet ndaj tyre kamatës dhe kryejësë.

Organeve shtetërore dhe agjencive qeveritare iu nevojiten për marrjen e vendimeve në fushën e legjisllacionit dhe vendimeve tjera .

Autoritetet fiskale i shfrytëzojnë këto informata nga shpallja e pasqyrave financiare në mënyrë që të konstatojnë nëse ka pasur humbje nga tatimet nga ndërmarrja e caktuar. Po ashtu me rastin e regjistrimit në bursa të kompanisë së caktuar atëherë organet drejtuese të

bursave do të shfrytëzojnë informacionet nga pasqyrat financiare të audituara dhe të prezantuara.

Shoqatat consulting duke shfrytëzuar këto informata u rekomandojnë klientëve të tyre se cilat janë kompanitë ku do të mundë të investonin për të blerë letra me vlerë.

Asociacionet e ndryshme industriale i përdorin këto informata si të dhëna statistikore për nxjerrje të raporteve për konjunkturën e degëve industriale.

Personeli i ndërmarrjes shfrytëzon raportet financiare për të vendosur për ardhmërinë e tij nëse do të jetë edhe në të ardhmen pjesë e personelit të ndërmarrjes së caktuar, duke identifikuar vështërsit apo përparësitë potenciale për pagën e ardhshme të tij.

Kontabiliteti i menaxhmentit

Është është një sistem i informacionit që si qëllim ka përgatitjen, raportimin dhe interpretimin e informacioneve të kontabilitetit që kanë përdorim interno në ndërmarrje për nevoja të marrjes së vendimeve të ndryshme. Kontabiliteti i menaxhmentit përdoret nga ana e menaxherëve për marrjen e vendimeve lidhur me:

- a) Planifikimin operativ i cili kërkon nga menaxherët që t'i identifikojnë qëllimet dhe zhvillojnë strategjitë adekuate për realizimin e atyre qëllimeve,
- b) Kontrollin me qëllim të vlerësimit të arritjeve të deritanishme të biznesit, dhe varësisht rezultateve në realizimin e qëllimeve bëhen dhe përshtaten ndryshime adekuate në aktivitetin e biznesit të tyre,
- c) Menaxhimi i kostos lidhet me përcaktimin e shpenzimeve në aktivitetin e ndryshme afariste dhe njëherit mat koston e produkteve të gatshme.

Zhvillimet e rregullimit kontabël dhe organizatat profesionale ndërkombëtare të kontabilitetit

Me qëllim lehtësimin e qarkullimit të kapitalit dhe mallrave në tregun ndërkombëtar në mesin e shumë masave që janë ndërmarrë kanë qenë edhe përpjekjet ndërkombëtare për standardizimi i informatave të kontabilitetit financiar si në aspektin formal ashtu edhe përmbajtësor.

Standardet ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) si qëllim parësor kanë harmonizimin e sistemeve të kontabiliteteteve, të të gjitha shteteve, dhe aplikimin e rregullave unike në raportimin financiar.

Shembull:

BPRAL AAB Kontabilitet Ushtrime java I 09/03/2015

Pasqyrat financiare vjetore të publikuara nga njëra ndër kompanitë e fuqishme e cila ka shtrirje ndërkombëtare si psh "NIKE" do të mundë kuptohen (lexohen) dhe përdorën për nevoja të ndryshme edhe nga një kontabilist në Kosovë, apo kompani e interesuar për gjendjen e kompanisë në fjalë, falë përmbajtjes së standardizuar që përmbajnë këto raporte financiare.

Vazhdim i shembullit

Sipas Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 1 (SNK 1) – Paraqitja e Pasqyrave Financiare të Kompanisë "NIKE" sipas kërkesave të SNK ,

- do të bëjë që të eliminohen ngatërresat apo pakuptimsitë që do të përmbajnë informacionet në Pasqyrat Financiare,
- detyrojnë kompanitë të shpalosin politikat e kontabilitetit të përdorura në përgatitjen e pasqyrave financiare,
- detyrojnë kompanitë të shpalosin më shumë informacione të kontabilitetit se sa do të kishin shpalosur zakonisht nëse nuk do të kishin ekzistuar standardet e kontabilitetit.

Komiteti për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASC)

Komiteti për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASC), është më i rëndësishmi organizim nga të gjitha trupat profesionale që kanë qëllim standardizimin e kontabilitetit.

Daton që nga viti 1973, kurse selia gjendet në Londër. Kjo organizatë profesionale ndërkombëtare e kontabilitetit është e pavarur prej të gjitha trupave të tjera profesionale.

Nga viti 1983 IASC është në lidhje të ngushta bashkëpunimi me Federatën Ndërkombëtare të Kontabilistëve (IFAC). Trupat profesionale të cilat janë anëtarë të IASC-së, njëkohësisht të njëjtit janë edhe anëtarë të IFAC-ut.

Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IASB)

Përgjegjësitë kryesore të IASB-së janë:

- Zhvillimi dhe publikimi i standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, dhe
- Aprovimi i interpretimeve të zhvilluara nga Komiteti për interpretimet e Raportimit Financiar Ndërkombëtar

Në strukturën e re të funksionimit të IASB-së brenda Fondacionit të IASC-së funksionojnë edhe:

1. Këshilli i Mbikqyrjes së Standardeve (SAC)- mbikëqyr punën e IASB dhe IASCF-së,
2. Komiteti i Interpretimit për Raportimin Financiar Ndërkombëtar (IFRIC)- zhvillon interpretimet e aplikimit të standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar, të cilat pastaj duhet të aprovohen nga IASB
3. Grupet Punuese- punojnë në projektet e mëdha të kontabilitetit.

Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (IFAC)

Organizmat ndërkombëtare për profesionin e kontabilistit. Janë 157 asociacione nga 123 shtete të cilët përfaqësojnë më shumë se 2.5 milion kontabilistë të punësuar në praktikën publike, tregti, industri, qeveri, etj. Është themeluar më 1977, kurse detyrat kryesore të kuaj trupe kanë të bëjnë me nxjerrjen e udhëzimeve dhe standardeve ndërkombëtare për auditim, etikë, edukim profesional dhe kontabilitet të menaxhmentit. Organizohen takime në patronatin e IFAC-ut çdo 5 vjet.

Zhvillimet dhe trupat profesionale të kontabilitetit në Evropë

Me qëllim të lëvizjes sa më të lirë të mallrave dhe shërbimeve si dhe kapitalit brenda shteteve anëtare të BE-së, është e nevojshme të sigurohen informacione financiare homogjene për kompanitë e të gjitha shteteve. Meqenëse kompanitë e këtyre shteteve ato duhet të jenë subjekt i ligjeve dhe sistemeve tatimore të njëjta. Ky para është roli i harmonizimit dhe standardizimit të raportimit financiar. Komisioni i BE-së ka dhënë kontribut të rëndësishëm në këtë proces përmes direktivave dhe dispozitave.

Federata e ekspertëve evropianë të kontabilitetit (FEE) është themeluar në vitin 1987 me seli në Bruksel. Anëtarë të kësaj federate janë shoqatat e kontabilitetit nga shumë shtete të Evropës. Aktiviteti i kësaj federate janë nga fushëveprimi i kontabilitetit, auditimit dhe tatimeve, si dhe ekzaminimi dhe eliminimi i diferencave ndërkombëtare në kontabilitet.

Organizatat e Kontabilitetit në SHBA

Në SHBA ekzistojnë disa organizata dhe trupa profesionale të kontabilitetit, të cilat ndikojnë në zhvillimin e teorisë dhe praktikës së kontabilitetit, ku ndër të tjera janë:

- a) Komisioni i letrave me vlerë (SEC), krijimin e rregullave dhe zbatimin e tyre në raportet financiare të kompanive të cilat shitjen e letrave me vlerë ia dedikojnë publikut të gjërë.
- b) Bordi i Standardeve të Kontabilitetit Financiar (FASB) është trup e profesionale private e kontabilitetit financiar e formuar më 1973. Është autoriteti kryesor për formulimin e standardeve dhe rregullave tjera në SHBA të cilat fuqinë juridike e marrin pas aprovimit nga agjencioni qeveritar SEC.

- c) Instituti amerikan për kontablistë të sektorit publik (AICPA)
- d) Asociacioni i kontablistëve amerikanë (AAA)

Zhvillimet e kontabilitetit në Kosovë

Që nga periudha e pasluftës në Kosovë ka filluar të zhvillohet dhe promovohet kontabiliteti në përgjithësi si dhe profesioni i kontabilitetit dhe auditorëve në veçanti.

Është themeluar Këshilli Kosovar mbi Standardet për Raportim Financiar. Ky këshill ka kompetenca për mbikëqyrjen dhe krijimin e standardeve të kontabilitetit të cilat funksionojnë në Kosovë. Kompanitë e ndryshme në Kosovë janë të obliguara që në harmoni me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit si dhe Standardet Kosovare të Kontabilitetit të dorëzojnë pasqyrat financiare tek ky institucion. Këto pasqyra duhet të jenë të audituara nga një auditor i licencuar para se të dorëzohen ne Këshillin Kosovar për Raportim. me rastin e